



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:108056  
Datë: 11.01.2024  
Numri i dokumentit: 05176703

**SCC -10 – 0288**

**Paditës:** Xh G B G ( Z ), P G ( K ) Xh G1 , L G ( T ) L G ( H ) Sh G M dhe N G, të gjithë nga Shkodra, të përfaqësuar nga avokati Y Z këtë me autorizim bartës te avokati F Sh nga Prishtina .

**Kundër**

**Të paditurës :** NSH „ Ereniku ” të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit ( AKP) në Prishtinë, Rr. „ Driton Hoxha ”, nr. 55, e këtë me autorizim V H .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përberë nga Gjyqtari Kryesues Hasim Sogojeva dhe Gjyqtaret anëtar Asllan Krasniqi dhe Diellza Hoxha, pas mbajtës së seancës dëgjimore publik, më dt. 21.11.2023, data e vendimit 11.01.2024 mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve 1. Xh G 2. Xh G1, 3. B G ( Z ), 4. P G ( K ) 5. Xh G2 , 6. L G ( T ) 7. L G ( H ) 8. Sh G ( M) dhe 9. N G, me të cilën kanë kërkuar të vërtetohet se paditësit janë bashkëpronarë të sipërfaqes së tokës 1,79.80ha, të ish ngastrave kadastrale nr...., dhe., tani të evidentuara si ngastra kadastrale., me kulturë arë, klasë tretë, me sipërfaqe 0.96.90ha, kulturë arë, klasë e katërt me sipërfaqe 3.40.22ha, kulturë arë, klasë e pestë, me sipërfaqe 7.32.61ha, në sipërfaqe të tërësishme 11.69.73ha, dhe ngastrës..., me kulturë arë, klasë e katërt, me sipërfaqe 4.12.50 ha, me kulturë arë, klasë e pestë, me sipërfaqe 12.71.30ha, kulturë arë, klasa gjashtë, me sipërfaqe 3.37.70ha, me sipërfaqe të tërësishme 20.21.50ha, në ZK Gjakovë, jashtë qytetit, Komuna Gjakovë.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës .**

## **Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 06 tetor 2010, paditësi Xh M G ka ushtruar padi kundër të paditurit lidhur me kërkesën për vërtetim pronësie për ngastrën kadastrale nr. ..dhe.., me kulturë arë dhe kullosë në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.79.80 ha sipas Fletë posedimit nr...., ZK Gjakovë- Jashtë qytet.

Me parashtresë është deklaruar se babai i tij M , por i quajtur si R A G ish nga Gjakova ka qenë pronar i ngastrave lëndore, por pas përfundimit të luftës së dytë botërore dhe fitores së komunizmit babai i ndjerë ishte shpërngul në Shqipëri dhe në vitin 1948, pas prishjes së raporteve në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë ai ka mbetur në Republikën e Shqipërisë, Shkodër dhe nuk ka pasur mundësi as të interesohet për pronën e tij. Në mungesë të tij në Kosovë, organet shtetërore kanë bërë ndryshimet kadastrale dhe kjo pronë është shndërruar si pronë shoqërore.

Si prova ka paraqitur:

- Historiati lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe pronë e Komunës së Gjakovës.
- Një deklaratë e dëshmitarit N P nga Gjakova.
- Certifikatën e lindjes së paditësit .

Më dt. 06.01.2012, AKP përmes përfaqësuesit të tij, ka dorëzuar parashtresën në Mbrojtje ne padi, me te cilën ka kundërshtuar ne tërësi padinë dhe pretendimet në padi si të pa bazuara në ligj, pasi që paditësi nuk ka prezantuar dëshmi të besueshme se ai është trashëgimtar i paraardhësit të tij dhe kërkon nga Gjykata që kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazuar në ligj.

Në parashtresë është deklaruar se edhe në supozim se ekziston baza juridike e kërkesëpadisë, në mbështetje të nenit 268 të Ligjit për punën e bashkuar e paditura NSH ,, Ereniku ''e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese , pasi që sendi ka kaluar në pronësi shoqërore dhe kthimi i saj nuk është kërkuar brenda afatit ligjor për vite, respektivisht 10 vite . Me këtë dispozitë është paraparë, ,, Nëse paluajtshmerisa kalon në pronë shoqërore edhe pa bazë juridike , kthimi i sendit mund të kërkohej në afatin prej 5 vitesh , nga dita e të kuptuarit , e më së voni në afatin prej 10 vitesh '' . Nga padia rezulton se ajo është parashkruar pasi e paditura është regjistruar si pronare nga viti 1958.

Me dt. 30.07.2012, paditësi përmes avokatit R Gj ka dorëzuar parashtresën me te cilën ka kundërshtuar mbrojtjen e AKP-së, me arsyetim :

- I. Nga provat e bashkangjitura në padi rezulton se ngastrat kadastrale nr. ..në sipërfaqe prej 0.73.64 ha dhe nr. ..në sipërfaqe prej 1.06.16 ha kanë qenë të evidentuara në emër të Rr A G nga Gjakova i cili para shumë vitesh ka vdekur.
- II. Nga deklarata e dëshmitarit N P nga Gjakova vërtetohen faktet se paditësi është djali i tani të ndjerit Rr G i cili është quajtur M G, nga Gjakova.
- III. Nga Certifikata e lindjes rezulton se paditësi Xh është i biri tani të ndjerit M G e që në Librat Kadastral është shkruar emri "Rr".

Në parashtresë është deklaruar se paditësi është trashëgimtar ligjor i M G, dhe se paraardhësi i tij asnjëherë nuk ka hequr dorë nga prona, dhe se ndryshimi i pronës është bërë pa vullnetin e tij. Ky transformim është në kundërshtim me nenin 17.2 të Deklaratës Universale të Drejtave të

Njeriut , ku thuhet „askush në mënyrë arbitrare nuk mund të provohet nga prona e tij ”. Është thirr edhe në praktikën juridike .

Më dt. 20.10.2022, paditësi ka dorëzuar një parashtrësë dhe ka kërkuar që rasti i tij të shqyrtohet nga gjykata , ka dorëzuar :

- Autorizimin për K G, të vërtetuar te noteri Sh V,
- Formularin e kërkesë kreditore, dt. 26.07.2024,
- Historiatin e pronës, dt. 03.07.2017,
- Raporti i lëshuar nga Komuna e Gjakovës dt. 06.11.2019,
- Skica,
- Aktvendimin, e lëshuar nga Këshilli Popullor i Komunës së Gjakovës në vitin 1958, nr. 01- 9265/1958,
- Aktvendimi, nr.01-566/11959,
- Dokumenti në emër të R G, lidhur me pronat në kopje .

Më dt. 08.12.2022, DHPGJS ka lëshuar Urdhër SCC- 10- 0288, për paditësin, ashtu që ju është kërkuar të plotëson padinë e tij kundër të paditurit duke provuar legjitimitetin aktiv, të dorëzon dëshminë për shqyrtimin e trashëgimisë për paraardhësin e tij , nuk ka dëshmi se është i vetmi trashëgimtar, të siguroi një ekspertizë gjeodezike me ekspert të gjeodezisë , duke u bazuar në historiatin e pronës të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, pastaj të precizon kërkesëpadinë .

Më dt. 19.12.2022, i autorizuari i paditësit avokati R Gj, e ka njoftuar Gjykatës se ka ndërprerë kontaktet me paditësin dhe se atij i nevojitet një kohë ma e gjatë për të vepruar sipas urdhrin.

Më dt. 11.01.2023, Gjykata e ka njoftuar të autorizuarin e paditësit për zgjatje të urdhrin dt. 08.12.2023, deri më dt. 26.06.2023 .

Më dt. 04.05.2023, avokati R Gj ka dorëzuar parashtrësën me të cilën e ka njoftuar gjykatën se nuk është më përfaqësues i paditësit dhe si përfaqësues i tij është vetëm K G, ashtu edhe nuk i posedon as shkresat e lendes .

Ka bashkangjitur procesverbalin e dt. 01.05.2023, për dorëzimin e shkresave të lendes te K G.

Më dt. 29.06.2023, i autorizuari i paditësit Y Z ka dorëzuar parashtrësën me të cilën është deklaruar se si paditës janë : Xh G, B G, P G, Xh G ( sipas dokumenteve Xh) L G, L G, dhe N G. Sipas kësaj parashtrëse është bërë zgjerimi i padisë në pikëpamje subjektive dhe paditësit nuk kanë bërë ndarje të trashëgimisë për ngastrat kontestuese . Pastaj ka theksuar se Akti i vdekjes së M G dt. 05.07.2002, është përpiluar te noteri A A në Shkodër dhe me të janë vërtetuar se kush janë trashëgimtarët e të ndjerit.

Në parashtrësë është deklaruar se është nxjerr ekspertiza gjeodezike me ekspertin Xh T dhe A M, për identifikimin e ngastrave lëndore ..dhe ....., dhe në ditën e identifikimit të këtyre ngastrave të njëjtat ishin të mbjellura me grurë nga personi NN .

Sipas ekspertizës gjeodezike rilevimi për ngastrat ..dhe.., janë shkruar indikacionet R A G, dhe i njëjti nuk është ftuar në shqim publik për shkak se nga vitit 1949, marrëdhëniet ndërshtetërore në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk kanë qenë nivel , edhe sikur të ishte ftuar në shikim publik M G, kufiri në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ka qenë i mbyllur . Për këtë organet e atëhershme kanë vendosur që pronat e tilla të regjistrohen në emër të Kuvendit Komunal në

Gjakovë . Pastaj me kalim të viteve titullari i pronës ndryshon dhe këto prona kalojnë në emër të Kooperativës Bujqësore dhe në Kombinatin Bujqësor .

Ka theksuar se ish ngastrat ..dhe.., tani janë pjesë përbërëse e ngastrave.., me kulturë, arë klasë tretë, me sipërfaqe 0.96.90ha, kulturë arë klasë e katërt me sipërfaqe 3.40.22ha, kulturë arë klasë e pestë, me sipërfaqe 7.32.61hana, në sipërfaqe të tërësishme 11.69.73ha, dhe ngastrës.., me kulturë arë klasë e katërt, me sipërfaqe 4.12.50ha, me kulturë arë klasë e pestë, me sipërfaqe 12.71.30ha, kulturë arë klasa gjashtë, me sipërfaqe 3.37.70ha, me sipërfaqe të tërësishme 21.50ha.

Ka precizuar kërkesën padinë, si në vijim :

„, APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Xh G, B G, ( Z) P G ( K) , Xh G ( sipas dokumenteve Xh) L G ( T) L G ( H) , Sh G M dhe N G të gjithë nga Shkodra .

VËRTETOHET se paditësit janë bashkpronarë të ish ngastrave kadastrale nr...., me sipërfaqe 1.06.16ha, dhe nr...., me sipërfaqe 0.73.54 të cilat shtrihen në ngastra kadastrale.., me kulturë arë klasë tretë, me sipërfaqe 0.96.90ha, kulturë arë klasë e katërt me sipërfaqe 3.40.22ha, kulturë arë klasë e pestë, me sipërfaqe 7.32.61hana, në sipërfaqe të tërësishme 11.69.73ha, dhe ngastrës.., me kulturë arë klasë e katërt, me sipërfaqe 4.12.50ha, me kulturë arë klasë e pestë, me sipërfaqe 12.71.30ha, kulturë arë klasa gjashtë, me sipërfaqe 3.37.70ha, me sipërfaqe të tërësishme 21.50ha në ZK Gjakovë jashtë qytetit , Komuna Gjakovë.

Detyrohen të paditurat KB Ereniku , Gjakovë dhe AKP-ja , që paditësve t’ ua paguajnë shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK .”

Kësaj parashtrese ja ka bashkangjitur :

- Prokurë e posaçme e lëshuar nga Noteri, O A K, Shkodër, dt. 23.06.2023, Pasaportën për Xh G,
- Certifikata e vdekjes për M G, lëshuar më dt. 19.12.2022, nga Bashkia Shkodër, Zyra e gjendjes Civile ,
- Prokurë e përgjithshëm nga noteri A A A në Shkodër ,
- Raporti gjeodezik, skica e matjeve dhe fotografi nga vendi i ngjarjes e gjeodetëve Xh T dhe A M .

Më dt. 31.07.2023, AKP-ja , përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit në pikëpamje të ekzistimit të legjitimitetit aktiv të paditësit, në aspektin objektiv ka theksuar se ngastrat lëndore janë pronë shoqërore dhe se paraardhësi i paditësit ka qenë pasiv dhe i pa interesuar për të fituar të drejtën e pronësisë. Në kundërshtimin e vetë e paditura është thirr edhe në dispozitën e nenit 268 të Ligjit për punën e bashkuar që është rregulluar situata juridike konkrete.

Në lidhje me ekspertizën gjeodezike ka kundërshtuar nxjerrjes e saj dhe është deklaruar se e njëjta është e mangët, dhe kundërthënëse.

Kësaj parashtrese nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë .

Më dt. 05.09.2023, DHPGJS, ka lëshuar njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore publike për dt. 26.09.2023, e cila nuk është mbajtur sipas kërkesës së të autorizuarit të paditësve .

Më dt. 12.10.2023, DHPGJS, ka lëshuar njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore publike për dt. 22.11.2023, në të cilën palët janë ftuar në mënyrë të rregullt.

Më dt. 22.11.2023, është mbajtur seanca dëgjimore publike në të cilën kanë prezantuar: për paditësit sipas autorizimit bartës avokati F Sh, për të paditurin NSH Kombinati Bujqësore Ereniku, përfaqësuesi i AKP-së, V H .

Për paditësit avokati F Sh është deklaruar : Qëndrojmë pran padisë, dt. 16.09.2010, dhe parashtresave të dorëzuara deri më tani në gjykatë. Ka theksuar paraardhësi i paditësve M G, ka vdekur dhe ky fakte vërtetohet me certifikatën e vdekjes, dt. 26.09.2023, ndërsa në bazë të certifikatave të lindjes paditësit, janë trashëgimtar ligjor dhe at : B G, P G, L G, Sh G, Xh G , N G, Me parashtresë është bërë precizimi i kërkesëpadisë . Më tej ka theksuar se ish ngastrat nr. ..dhe.., ju janë bashkuar ngastrave ..dhe.., kjo rrethanë është sqaruar me ekspertizë gjeodezike, por ashtu edhe me historiat të pronës të lëshuar nga Komuna e Gjakovës.

Ka theksuar se pretendimi i të paditurës për parashkrim të kërkesës duke u thirr në dispozitë të nenit 258 të Ligjit për punën e bashkuar nuk qëndron pasi paraardhësi i paditësve ka qenë i detyruar të shpërngulet në Shqipëri dhe se nuk ju është lejuar kthimi në Kosovë . Nuk ishte e rëndësishme që paditësi të merr pjesë në tubime për veprimet e të paditurës në mungesë të bazës ligjore dhe paraqet si posedim me keqbesim për tërë kohën sa ka qenë, prandaj kërkojmë që kërkesëpadia të aprovohet.

Për AKP-në, përfaqësuesi është deklaruar : Mbesim pran parashtresave të dorëzuara në gjykatë edhe një herë deklarojmë se e kontestojmë bazën juridike të kërkesëpadisë , sepse nuk ka prova të cilat e mbështesin kërkesëpadinë, sikundër që gjykatës ja dorëzojmë certifikatat e pronës, ndërsa me shkrim e kemi përgatitur fjalën përfundimtare.

Në fjalën përfundimtare është deklaruar se në vitin 1958, me vendimin nr. 2106/1-58, 1353/1-59, 9508/1- 58-01 566/1- 59, nga organi kompetent, ngastrat lëndore ..dhe.., kanë kaluar në emër të paditurit . Bazuar në këtë prova i padituri nga vitit 1958 është në posedim të ngastrave dhe se paraardhësi i paditësve nuk ka prova që ka kërkuar pronën kontestuese .

Më tej ka theksuar se meqenëse kemi vendime administrative dhe kundër të njëjtave nuk ka ankesa, Dhoma nuk ka juridiksion të vendos në këtë çështje .

Gjykata pasi ja dorëzoi provën e certifikatës së pronës të autorizuarit të paditësve, ja dha mundësin në një afat prej 30 ditëve të deklarohet.

Më dt. 21.12.2023, përmes postës i autorizuari i paditësve ka dorëzuar parashtresën e fjalës përfundimtare sipas të cilës është deklaruar në lidhje me legjitimitetin aktiv dorëzoi , dëshminë e lëshuar nga noteri O A . K, në Shkoder që vërteton se Xh G, B G, P G, Xh G L G, L G Sh G, dhe N G janë trashëgimtar të M G.

Më tej ka theksuar se gjatë procedurës gjyqësore është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, përkatësisht ish ngastrat nr. ..dhe.., tani janë pjesë përbërëse e ngastrave... Është vërtetuar se këto ngastra kanë qenë në emër të M G, prindi i paditësve, dhe se i njëjti nuk është ftuar për shqim publik për shkak se nga vitit 1949, marrëdhëniet ndërshtetërorë mes Shqipërisë dhe

Jugosllavisë nuk kanë qenë në nivel, edhe sikur të ishte ftuar, për shkak se kufiri ka qenë i mbyllur, ai nuk do të kishte pasur mundësi të merr pjesë. Për këtë organet e atëhershme kanë vendosur që prova të regjistrohet në emër Kuvendit Komunal në Gjakovë. Përsëri ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, si më poshtë :

„ APROVOHET kërkesëpadia e paditësve 1) Xh G, 2. Xh G, 3. B G, ( Z ) 4. P G ( K ), 5. Xh G , 6. L G ( T ) 7. L G ( H ) , 8. Sh G M dhe 9. N G të gjithë nga Shkodra .

VËRTETOHET se paditësit janë bashkëpronarë të sipërfaqes prej 1,79.80ha, ish ngastrave kadastrale nr..., dhe..., tani të evidentuara si ngastra nr..., me kulturë, arë klasë tretë, me sipërfaqe 0.96.90ha, kulturë arë klasë e katërt me sipërfaqe 40 -22ha, kulturë arë klasa pestë, me sipërfaqe 7.32.61ha , në sipërfaqe të tërësishme 11.69.73ha, dhe ngastrës..., me kulturë arë klasë e katërt, me sipërfaqe 4.12.50ha, me kulturë arë klasë e pestë, me sipërfaqe 12.71.30ha, kulturë arë klasa gjashtë, me sipërfaqe 3.37.70ha, me sipërfaqe të tërësishme 20. 21.50 ha në ZK Gjakovë jashtë qytetit , Komuna Gjakovë.

DETYROHEN të paditurat KB Ereniku , Gjakovë dhe AKP-ja , që paditësve t' ua njohin këtë të drejtë dhe të njëjtit t' i lejojnë që këtë të drejtë t@ a regjistrojnë në organet kompetente kadastrale në afatin prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

DETYROHEN të paditurat që paditësve t' ua paguajnë shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK .

Ka bashkangjitur : - Certifikatën e vdekjes ,  
- Vendimin për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të lëshuar nga noteri Odeta A. Kërzhalliu, dt. 13.12.2023, Republika e Shqipërisë, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

- Certifikatë Familiare,  
- Certifikatë martese,  
- Certifikatë vdekje për Xh G, i lindur më dt. 15.05.1919, ka vdekur më dt. 20.05.2010,

- Certifikatë vdekje për B G, e lindur më dt. 20.06.1929, ka vdekur më dt. 23.01.1933,

- Certifikatë vdekje ,H G , ka lindur më dt. 20.05.1933, ka vdekur më dt. 28.07.1933,

- Certifikatë personale për B Z, ka lindur më dt. 27.04.1937,  
- Certifikatë personale për P K e lindur më dt. 28.03.1939,  
- Certifikatë personale për Xh G , i lindur më dt. 20.03.1941,  
- Certifikatë vdekje për L T, e lindur më dt. 30.10.1943, ka vdekur më dt. 23.05.2019,

- Certifikatë personale për L H, e lindur më dt. 28.02.1946,  
- Certifikatë personale për Xh G, i lindur më dt. 01.01.1951,  
- Certifikatë vdekje Xh M, e lindur më dt. 01.01.1951, ka vdekur më dt. 07.10.1982,

- Certifikatë personale për Sh M, e lindur më dt. 26.02.1953,  
- Certifikatë personale për N G, i lindur më dt. 08.08.1955 .

## Arsyvetimi Ligjor

### **Kërkesëpadia e paditësve nuk është e bazuar .**

Gjykata pas përfundimit të procedurës me shkrim, sipas nenit 40 të Ligjit nr. 06/L-086, ka vendosur të mbaj seancë dëgjimore publike, ashtu që secilës palë ti mundësohet të deklarojë në pretendimet e veta në lidhje me kërkesëpadinë.

Gjykata vlerëson se paditësit me provat e dorëzuara nuk ka provuar faktin se të njëjtit janë të vetmit trashëgimtar ligjor të ndjerit M G, që sipas certifikatës së vdekjes dt. 19.12.2022, të lëshuar në Shkodër, dhe Vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, dt. 13.12.2023, të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, ashtu që i njëjti ka lindur më dt. 27.03.1890, dhe ka vdekur, më dt. 24.12.1978.

Gjykata vlerëson se Prokura e përgjithshme e lëshuar nga Noteri A XH A, ka të bëjë me përfaqësimin e palëve Xh G, P G, Xh G L G, Sh G, N G, për autorizim marrësin Xh G edhe pse në dokumente është shënuar emri Xh . Kjo prokurë është lëshuar më dt. 05 korrik 2022 në Shkodër.

Gjykata vlerëson se Xh G ka nënshkruar prokurë të posaçme për përfaqësim për avokatin Y Z te noteri O A K, në Shkodër më dt. 23.06.2023.

Bazuar në Vendimin dt. 13.12.2023, të noterës O A K , si trashëgimtar ligjor të M G janë : 1. Xh G, 2. B Z, 3. P K, 4. Xh G , 5. L T, 6. L H, 7. Xh G, 8. Xh M, 9. Sh M, dhe 10. N G.

Gjykatës, vlerëson bazuar në precizimin e kërkesëpadisë, dt. 29.06.2023, objekt i kërkesës janë pronat : ngastra nr..., me sipërfaqe 1.06.16ha, dhe]..., me sipërfaqe 0.73.64ha, e të cilat tani shtrihen në kuadër të ngastrave..., me kulturë arë klasë tretë, me sipërfaqe 0.96.90ha, kulturë arë klasa katërt, me sipërfaqe 3.40.22ha, me kulturë arë klasa e pestë me sipërfaqe 7.32.61ha, në sipërfaqe të tërësishme 11.69.73ha dhe në ngastrën..., me kulturë arë klasa katërt, me sipërfaqe 4.12.50ha , me kulturë arë, klasa pestë me sipërfaqe 12.71.30ha, me kulturë arë klasa gjashtë me sipërfaqe 3.37.70ha, në sipërfaqe të tërësishme 20.21.50ha.

Me provën e historiatit të lëshuar nga Komuna e Gjakovës dt. 27.09.2010 është konstatuar se në bazë të skicës..., të vitit 1932, ngastra nr..., është e pa identifikuar. Gjatë vitit 1955, Zona Kadastrale në Gjakovë jashtë qytetit është përfshirë në rreambulim ( azhurim ) matjet e tilla janë ekspozuar në shikim publik, pas shikimit publik, operati kadastral ka hyrë në fuqi, dhe ka rezultuar gjendja : ngastra nr..., ka pësuar ndarje dhe janë formuar ngastrat e reja ..deri në...

Ngastra nr. ...me kulturë kullor, klasa e tretë, me sipërfaqe 0.73.64ha, dhe..., me kulturë arë, klasa e pestë me sipërfaqe 1.06.16ha, sipas fletës së posedimit nr..., janë evidentuar PSH në emër të Kuvendit Komunal Gjakovë. Sipas skicës detaje, nr. 12/2, dhe 12/4, të vitit 1953-1956, janë evidentuar në emër të R, A G.

Në vitin 1957, në bazë të vendimit, nr. 11680/57, ngastra nr..., kalon në posedim të PSH, Ekonomia e Pyjeve , në Pejë.

Në vitin 1958, në bazë të Vendimit nr. 2106/1-58, 1353/ -59, 9508/1-58, 01-566/1,-59, ngastrat nr. ..dhe..., kalojnë në posedim të PSH KBI ,, Ereniku ” Gjakovë .

Në vitin 1967, në bazë të rivlevimit të ri të pasurisë KBI „ Ereniku ” ngastrat nr. ..dhe.., i bashkohet ngastrës.., me sipërfaqe 5.11.99ha, e cila evidentohet në posedim të PSH KBI „ Ereniku ” Gjakovë.

Sipas historiatit të dt. 03.07.2017, për ngastrat lëndore janë dhënë të dhënat edhe pas vitit 1967, ashtu që një pjesë e Zonës Kadastrale në Gjakovë Jashtë qytetit është e përfshirë në masën e komasacionit andaj edhe ngastra nr..., ishte e përfshin në komasacion. Në vitin 2013, me regjistrimin e Aktvendimit të Komisionit për Komasacion ngastra nr..., shtrihet në dy ngastra të formuara dhe at : një pjesë e saj në pjesën e ngastrës nr..., dhe një pjesë e sajë në pjesën e ngastrës nr....

Sipas dokumentit të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, për Zyrën Rajonale të AKP-së, në Pejë, dt. 06.11.2019, në lidhje me ngastrat lëndore ..dhe.., , ZK Gjakove, është deklaruar se nuk disponojmë dokument se si kanë kaluar në vitin 1953/56, prej personit R A G nga Gjakova në posedim të PSH Kuvendi Komunës së Gjakovës, por ekzistojnë skicat detaje nr. 12/2, dhe 14/4, në vitin 1953/56, ku këto ngastra figurojnë në emër të R A G, dhe krahas përgjigjejes ju dërgojmë edhe skicat detaje.

Bazuar në dokumentin e Aktvendimit të Këshillit Popullor të Komunës së Gjakovës, në vitin 1958, është vendosur : Ndërmarrjes „L B ” në Gjakovë ju jepet toka bujqësore nga fondi i pasurisë së përgjithshme popullore, në shfrytëzim pa pagesë për themelimin dhe formimin e vreshtarisë dhe pemëtarisë në Komunën e Gjakovës ngastrat si vijon ... dhe në te përfshihet ngastra nr..., arë, me sipërfaqe 1.06.16. ha.

Me raportin me shkrim të ekspertëve të gjeodezisë, Xh T dhe A M , dt. 23.05.2023, në lidhje me ngastrat lëndore ...dhe.., të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Gjakovë, Jashtë qytetit janë hartuar edhe skicat.

Ekspertet në raport me shkrimin janë deklaruar se identifikimi i pronave është bërë në prezencën, e palëve në procedurë Xh G, Xh G , N Xh G nga Shkodra dhe K S G, nga Gjakova, por me rastin daljes në vend shikim nuk ka provë, që ekspertet paraprakisht ta kenë njoftuar edhe AKP-në .

Ekspertet kanë konstatuar : ngastrat lëndore ..dhe.., në ditën e identifikimit ishin të mbjellura me grurë nga NN sepse në momentin e identifikimit nuk është gjetur asnjë njeri për të pyetur për shfrytëzuesin e tokës .

Gjatë rilevimit të gjendjes faktike nuk është vërejtur asnjë lloje kulture e përhershme në ngastrat lëndore . Nga pika fundore më veriore në ngastrën nr..., ekzistojnë dy shtylla të largpërçuesit të tensionit të lartë ku është përshkruar sak vendi i ndodhjes me matje gjeodezike

Sipas eksperteve Rilevimi ( matja ) e parë në këtë Zonë Kadastrale është kryer gjatë vitit 1931/1933, ndërsa përgatitja e terrenit ( vendosja e stabilizimit ) rrjetit Coordinativ „GaussKryger ” është kryer prej vitit 1928 deri në vitin 1931.

Të gjitha matjet janë ekspozuar në shikim publik të kryera në vitin 1931-33, për të fituar Plotfuqishmëri.

Prej viti 1933 deri në vitin 1945, është kryer mirëmbajtja e operatit kadastral por në fund të vitit 1945, për shkak të luftës është djegur Objekti në Zyrën e Kadastres, dhe ka arritur të shpëtoi një pjesë e dokumentacionit të Operatit Kadastral.



Në territorin e Zonës Kadastrale Jashtë Qytetit të Gjakovës nuk është ndërmarr asnjë veprim për tu regjistruar pronat në Kadastrën Përshkrues në vitin 1950.

Në vitin 1953 është vendosur që të kryhet në tërë territorin e Komunës së Gjakovës Rilevrimi gjatë viteve 1931- 1933, ( Revizioni Kadastral ) .

Prapë për të fituar plotfuqishmëri Rilevrimi , Rilevrimet e tilla janë ekspozuar në publik në shikim publik. Kjo punë është kryer nga ekspertë të gjeodezisë dhe dy njohës të mirë të terrenit dhe të rrethanave dhe të besuar të popullit. Gjatë rilevrimit për çdo ngastër është shënuar edhe indikacionet e pronarit apo pronarëve , kultura etj. Në rastin konkret gjatë rilevrimit për ngastrat nr. ..dhe..., janë shkruar indikacionet R A G. Por gjatë shikimit publik që ka zgjatu disa muaj janë ftuar çdo pronar të cilit ju është komunikuar : forma e ngastrës, kultura, sipërfaqja dhe të dhënat tjera. Pronari nëse ka qenë i pajtimit me të dhënat atëherë ka nënshkruar procesverbalin . Edhe pse gjatë Rilevrimit për ngastrat lëndore R A G nuk është ftuar për shikim publik. Sipas ekspertëve nga viti 1949, marrëdhëniet ndërshtetërore në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk kanë qenë të mira, dhe edhe sikur të ishte ftuar ai nuk kishte pasur mundësi me prezantuar pasi kufiri në mes shteteve ka qenë i mbyllur. Për këtë arsye kjo pronë është regjistruar si pronë shoqërore e Kuvendi Komunal në Gjakovë. Në rastin konkret edhe pse në skiq të detajeve është regjistruar në emër të R G, në regjistër të ngastrave është çregjistruar.

Pas kësaj Titullari i pronës shoqërore nga Kuvendi Komunal kalon në Kooperativën Bujqësore Kombinati Bujqësore për shkak të formimit të komplekseve të tokave.

Për shkak të shfrytëzimit të sistemit të ujitjes nga Hidrocentrali Radoniqi, në pjesën Rurale të ZK Gjakovë , Jashtë Qytetit është zbatuar masa Agroteknike e rregullimit të tokave – Komosacioni .

Ngastra lëndore ..dhe..., tani sipas gjendjes aktuale , ato janë pjesë e ngastrave..., me kulturë arë klasa e tret me sipërfaqe, 0.96.90ha, me kulturë arë, klasa katërt me sipërfaqe 3.40.22ha, me kulturë arë klasa e pestë, me sipërfaqe 7.32.61ha, ose me sipërfaqe të tërësishme 11.69.73ha. ndërsa ngastra nr..., është pjesë e ngastrës..., me kulturë arë, klasa e katërt me sipërfaqe 4.12.50ha, me kulturë arë klasa pestë me sipërfaqe 12.71.30ha, me kulturë arë klasa gjashtë me sipërfaqe 3.37.70ha, me sipërfaqe 20.21.50ha.

Në bazë të evidencave kadastrale nga operati kadastral rezulton se ngastra ...dhe..., janë Pasuri Shoqërore Kombinati Bujqësor ,, Ereniku ”.

Raportit me shkrim ju janë bashkangjitur edhe skicat me të dhëna të Koordinatave detaje të ngastrave lëndore, skica detaje e vitit 1955, faqja në kopje e regjistrit kadastral të vitit 1955, fotografit nga vend shikimi në lidhje me vendosjen e shtyllave të tensionit të lartë elektrik pastaj skica për ngastrat ..dhe..., në të cilat të dy ngastrat janë të përfshira në ..dhe...

Në ekspertizë gjeodezike vërejtje nuk ka bërë pala paditëse, ndërsa e paditura AKP , me parashtrësë dt. 31.07.2023, është deklaruar për ekspertizë në të cilën ka pasur vërejtje, por përkundër faktit se ajo e ka shërbimin e vetë profesional gjeodezik dhe kadastral , dhe edhe AKP-ja ka pasur mundësi që me parashtrësë të përgjigjes në padi të paditësit të dorëzoi ekspertizën gjeodezike të hartuar nga ekspertët e saj dhe në këtë mënyrë ti argumnetoi vërejtje e saja , ajo këtë nuk e ka bërë. Vërejtjet AKP-së në ekspertizë sipas parashtrësës së dt. 31.07.2023, gjykata i vlerësoi si të pa argumentuara me asnjë kundër provë tjetër.

Gjykata pasi bëri vlerësimin ekspertizës gjeodezike si provë, të ekspertëve të gjeodezisë, të njëjtën e vlerësoi si profesionale dhe të argumentuar në dokumentacion zyrtar që kanë pasur në disponim me rastin e hartimit të saj, por ekspertet si në raport dhe të skicës gjeodezike në pjesën që ka të bëjë me bashkimin e ngastrave lëndore, me ngastrat., dhe., nuk janë deklaruar për pjesën e ngastrës nr. ...me matje gjeodezike e cila shtrihet një pjesë në ngastrën nr. ..dhe ..., sikundër nuk janë deklaruar për pjesën e ngastrës., që është bashkuar me ngastrën ..., e cila është dashur të identifikohet me matje gjeodezike .

Këto mungesa të dhënave në ekspertizë gjeodezike, si në paragrafin mësipërm, nuk kanë pasur ndikim në vendosje meritorë të çështje, dhe në vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me ngastrat lëndore.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret paditësit me provat e dorëzuara me padi dhe parashtrës deri në seancën dëgjimore, nuk kanë provuar legjitimitetin e plotë të palës paditëse në këtë procedurë, sipas Vendimit të lëshuar nga noterja, pasi në padi nuk është përfshirë të dhëna për trashëgimtarët e vdekur të trashëgimlënësit se të njëjtit a' kanë lënë paraardhës së tyre, sikundër në supozim të mos kenë pasardhës është dashur të vërtetohet me ndonjë provë nga Zyra e Gjendjes Civile në Shkodër.

Gjykata vlerëson se paditësit janë përfaqësuar nga avokatet profesionit dhe avokatet profesionist është dashur që në padi dhe parashtrës të dorëzojnë këto prova, sikundër që kjo gjykatë e ka përmbushur obligimin e vetë ligjor, që palës ti jepet mundësia- koha e mjaftueshme për tu përgatitur për gjykim sipas Urdhrit dt. 08.12.2022 , por që nuk kanë vepruar, ndërsa Vendimin për trashëgimi ligjore e kanë dorëzuar vetëm pas përfundimit të seancë dëgjimore, dhe se edhe ky Vendim është kundërthënës me prova.

Gjykatës nga pala paditëse nuk ju është dorëzuar asnjë provë se paraardhësi i paditësve ka qenë banor i Kosovës, përveç që në certifikatë të vdekjes është shënuar vendi i lindje Gjakovë, deri në përfundimin e luftës së dytë botërore, ndërsa është vendosur në Shqipëri, Shkodër si i përndjekur përveç dëshmisë e cila është nënshkruar nga personi N P, e që nuk mund të vërtetohet se ky person si dëshmitar a' e ka nënshkruar këtë deklaratë, pasi deklarata nuk ishte e vërtetuar .

Gjykata vlerëson se përdorimi i emrit si shkurtes „Rr ” për të ndjerin M si zakon popullor edhe në supozim të jetë i saktë se kemi të bëjmë me personin e njëjtë, paditësit për këtë fakt është dashur të dorëzojnë dokument zyrtar nga Zyra e Regjistrimit civil në Shkodër ose Gjakovë .

Gjykata vlerëson se shënimi në Skica / Rilverim për ngastrat nr. ...dhe..., Rr ( A ) G nuk ka ndonjë të dhënë tjetër që për ngastrat në fjalë i njëjti ishte pronar, pavarësisht shpjegimeve të dhëna në ekspertizë gjeodezike dhe historiat të pronës. Sikundër nuk ka asnjë shpjegim se kush ishte pronar i ngastrës., sa ishte sipërfaqja e saj dhe sipas cilës procedurë është bërë ndarja fizike e ngastrës nr..., që janë formuar ngastrat e reja si ...deri në numrin ....

Në rastin konkret në supozim se M Rr A G , ka qenë pronarë i ngastrave..., dhe., i njëjti gjatë procedurës administrative të Rilevimit të ngastrave lëndore nuk kishte marre pjesë fare, dhe si pasojë e mos marrjes pjesë në këtë procedurë, ngastrat lëndore janë regjistrua në emër të Kuvendit Komunal në Gjakovë sipas fletës së posedimit nr.... Për këtë procedurë të regjistrimit nuk ka dëshmi të jetë ushtruar ndonjë mjet juridik .

Po ashtu është vërtetuar fakti se sipas konstatimit në historiat të pronës dt. 03.07.2017, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës në vitin 1957, në bazë të Vendimit 11680/57, ngastra nr. ...kalon në posedim të PSH Ekonomia e Pyjeve në Pejë , ndërsa sipas Vendimit 1958, nr. 2106/1-58,1353/1-59,9508/1-58 – 566/1 -59, ngastrat ..dhe.., kalojnë në posedim PSH KBI „Ereniku ” Gjakovë .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret paraardhësi i paditësit në bazë të një procedure administrative të rregulluar me ligj mbi Rilverim dhe Rregullores për tokat kadastrale e publikuar në Gazetën Zyrtare të Jugosllavisë .., dhe plotësuar 23/56, e viti 1953, pronat në fjalë janë regjistruar në emër të Kuvendit Komunal Gjakovë dhe se në supozim se paraardhësi i paditësit të ketë qenë pronarë, deri në vitin 1955, ai nuk kishte marrë pjesë në këto procedura dhe nuk ka autorizuar asnjë person për mbrojtje të interesave të tija para organeve administrative .

Gjykata vlerëson se edhe e paditura KBI „Ereniku ” si poseduese, por jo si pronare e palujatshmerive ka hyrë në posedim të ngastrave me Vendimin e Këshillit Popullor (Kuvendit të Komunës) së Gjakovës pa shpërblim dhe tani ngritët çështja se AKP-ja si menagjuese e NSH –ve, a’ ka autorizim që këtë pronë ta tjetërsoi për 99 vite, përderisa nga ish pronari Komuna e Gjakovës ju është bartur, vetëm të drejtën e posedimit të ngastrave, te NSH .

Gjykata vlerëson se paditësit si trashëgimtar të supozuar të M Rr A G, janë në raport juridiko administrativ dhe civil me Komunën e Gjakovës dhe nuk janë në asnjë raport juridiko civil me të paditurin KBI e cila është poseduese e ligjshme dhe me mirëbesim e ngastrave lëndore, pasi kishte hyrë në posedim në bazë të Vendimit të Komunës së Gjakovës .

Gjykata vlerëson se paditësit duke mos provuar legjitimitetin e plot aktiv dhe legjitimitetin e plot pasiv të paditurit „Ereniku ” të njëjtëve ju mungon baza juridike për të kërkuar vërtetimin e pronësisë në palutashmerit si në dispozitiv. Paraardhësi i paditësve, pavarësisht pengesave ligjore që ka pasur në situatën konkrete edhe ai vet ka kontribuar me pasivitetin e tij, i cili nuk ka autorizuar ndonjë familjar të tij ose person tjetër për të marrë veprime juridike në aspektin e mbrojtjes së të drejtave pronësore, në procedurën e Rilivrimit kadastral .  
Për këtë arsye edhe është refuzuar kërkesëpadia e paditësit.

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

### **Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi që secila palë ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari Kryesues, Hasim Sogojeva

Gjyqtar, Asllan Krasniqi

Gjyqtare, Diellza Hoxha